



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Dokument parlamentar

PROJEKTREZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;
- Duke vlerësuar rolin e institucionit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike;
- Duke e konsideruar mjaft të rëndësishëm këtë institucion për nxitjen e përdorimit me efektivitet, efizienz dhe ekonomi të fondeve dhe pronës publike dhe duke nënvizuar nevojën për përmirësime të mëtejshme në këtë drejtim;
- Duke nënvizuar nevojën për rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së;

Vlerëson veprimtarinë e KLSH-së për vitin 2017 në këto drejtime:

1. KLSH ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me Kushtetutën, strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe kuadrin ligjor e rregullator.
2. KLSH ka realizuar misionin e tij kushtetues e ligjor, duke informuar Kuvendin, palët e interesit dhe qytetarët, në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme e të plotë, mbi përgjegjshmërinë që tregojnë institucionet dhe entet publike në përdorimin e fondeve buxhetore. Ky informim ka kontribuar në përmirësimin e qeverisjes dhe thellimin e luftës kundër korrupsionit.
3. Në veprimtarinë audituese, KLSH është mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit, si dhe parimet e INTOSAI-t dhe EUROSAT-t. KLSH ka bërë përpjekje të vazhdueshme për

zbatimin e rekomandimeve të institucioneve homologe dhe mbikëqyrëse ndërkombëtare, si Gjykata Austriake e Auditimit dhe Gjykata e Auditimit e Moldavisë, SIGMA, si dhe rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit European.

4. Veprimtaria audituese e KLSH-së është zgjeruar krahasuar më një vit më parë, si në drejtim të numrit të auditimeve, ashtu edhe të numrit të institucioneve të audituara.

5. KLSH ka vijuar harmonizimin e formave të ndryshme të auditimit, duke i dhënë përparësi rritjes së peshës së auditimeve financiare, auditimeve të performancës dhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Në këtë mënyrë, KLSH ka vënë në zbatim rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të vitit 2016, si dhe rekomandimet e BE-së e SIGMA-s. Peshën kryesore të auditimit vijnë ta kenë auditimet financiare.

6. Në auditimin e performancës u realizuan objektivat e parashikuara, si rritja e numrit të auditimeve; rritja e numrit të subjekteve të mbuluara me këtë lloj auditimi; rritja e numrit të gjetjeve, konkluzioneve e rekomandimeve për çdo auditim; rritja e rolit këshillues e rekomandues të KLSH-së; zbatimi i akteve rregullatore, duke sjellë përmirësimin e cilësisë së auditimit.

Megjithatë, auditimet e performancës zenë ende një peshë të vogël në veprimtarinë audituese, krahasuar me ato të kryera nga institucionet homologe të zhvilluara. Edhe cilësia e këtyre auditimeve duhet të përmirësohet më tej.

7. KLSH ka realizuar rekomandimet për ngritjen dhe konsolidimin e auditimeve të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, duke rritur numrin e auditimeve të realizuara në krahasim me planin, e cila ka sjellë rritjen e mbulimit me këtë lloj auditimi. Konsolidimi i këtij auditimi specifik mbetet sfidë për KLSH-në, si një kërkesë e kohës.

8. KLSH ka vijuar punën për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, e cila vërehet në këto drejtime:

a) Gjatë auditimit, KLSH ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, me dëm efektiv në buxhetin e shtetit. Edhe këtë vit, shkeljet më të mëdha janë në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore dhe prokurimin publik. Kjo tregon se është e nevojshme të rritet përgjegjshmëria menaxheriale për të garantuar një sistem menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më efektiv.

b) KLSH, edhe për vitin 2017, ka arritur tregues pozitivë të efektivitetit të auditimeve, duke ruajtur një raport të kënaqshëm midis shpenzimeve të institucionit dhe vlerës së dëmit ekonomik të zbuluar e të rekomanduar për t'u zhdëmtuar.

9. KLSH i ka kushtuar një vëmendje të posaçme rritjes së forcës rekomanduese të institucionit për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara. Për gjetjet nga auditimi, KLSH ka dhënë rekomandimet përkatëse në format e:

- Shpërblimit të dëmit shkaktuar buxhetit;
- Masave me karakter organizativ, administrativ e disiplinor;

- Propozimeve për ndryshim aktesh ligjore e nënligjore;
- Kallëzimeve penale.

Pjesa më e madhe e kallëzimeve penale konstatohet në auditimin e njësive të qeverisjes vendore, e ndjekur nga auditimi i aseteve dhe mjedisit. Në këto kallëzime janë ngarkuar me përgjegjësi penale titullarë institucionesh, nëpunës të nivelit drejtues etj.

Rekomandon për KLSH-në për vitin 2018:

1. Objektivi kryesor i veprimtarisë së KLSH-së duhet të jetë nxitja e rritjes së përgjegjshmërisë dhe transparencës për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi të pasurisë publike, duke forcuar integritetin e institucionit dhe duke rritur besimin e publikut.
2. KLSH duhet të vijojë e thellojë përpjekjet për forcimin e pavarësisë së institucionit, për të siguruar auditime të paanshme dhe objektive.
3. Kryerja e veprimtarisë audituese në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, si dhe me standardet ndërkombëtare të auditimit mbetet një detyrë e vazhdueshme e institucionit. Kjo kërkon vijimin dhe thellimin e punës së audituesve për njohjen e legjislacionit dhe të standardeve ndërkombëtare të auditimit, të cilat janë në zhvillim. Gjithashtu, vijimi i veprimtarisë trajnuese për rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve është me rëndësi në këtë drejtim.
4. Metodologjia e auditimit duhet të zhvillohet e përmirësohet më tej. Në themel të saj duhet të jetë auditimi me bazë risku, i cili ndikon në rritjen e efikasitetit të veprimtarisë audituese dhe të përdorimit të fondeve publike.
5. Fokusi i veprimtarisë audituese duhet të jetë drejt rritjes së peshës së auditimit të performancës, për shkak të rolit mjaft të rëndësishëm që ka ky lloj auditimi në rritjen e efektivitetit, efikasitetit dhe përdorimit me ekonomi të fondeve publike. Cilësia e auditimeve të performancës duhet të përmirësohet më tej, duke thelluar analizën e riskut, njohur më mirë standardet ndërkombëtare të auditimit, rritur kapacitetet profesionale të audituesve etj.
6. Një detyrë e rëndësishme mbetet thellimi i auditimit të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet konsolidimit dhe përdorimit të elementëve të tij në auditimet e përputhshmërisë, financiare dhe të performancës.
7. Përmirësimi i cilësisë së auditimit është një detyrë e vazhdueshme e institucionit, për të rritur dobinë e tij. KLSH duhet të adoptojë Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, i cili përfshin kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë. Kontrolli i cilësisë duhet të konsolidohet, nëpërmjet zbatimit me korrektësi të kuadrit ligjor e rregullator. Ky kontroll duhet të mbështetet nga sigurimi i cilësisë, të kryer nga persona që nuk kanë marrë pjesë në procesin e auditimit.
8. KLSH duhet të forcojë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, nëpërmjet përmirësimit të procedurave brenda institucionit dhe forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional. Rol të

rëndësishëm ka këtu bashkëpunimi me Komisionin për Ekonominë dhe Financat, nëpërmjet informimit progresiv mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara.

9. Megjithë rritjen e konsiderueshme të transparencës në publikimin e rezultateve të auditimit, KLSH duhet të fokusohet më shumë në drejtim të përcjelljes profesionale dhe të kuptueshme të mesazhit të auditimit tek palët e interesuara dhe qytetarët. Kjo do të ndikojë në rritjen e impaktit të raportimeve të KLSH-së, duke zgjeruar bazën e përdoruesve të tyre.

10. Zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së për përmirësimin e kuadrit ligjor e rregullator është i rëndësishëm për të përmirësuar administrimin e fondeve e pronës publike, si dhe për të thelluar luftën kundër korrupsionit. Me rëndësi të veçantë është rekomandimi i KLSH-së për hartimin dhe miratimin e ligjit për përgjegjësinë materiale.

11. KLSH duhet të ndjekë me përparësi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të papaguara si nga subjektet publike, ashtu edhe nga tatimpaguesit, duke synuar reduktimin e tyre.

12. KLSH duhet të ndjekë, gjithashtu, zbatimin e rekomandimeve për shpërblimin e dëmit, duke synuar që e gjithë vlera e dëmit ekonomik të arkëtohet në buxhetin e shtetit.

13. Kuvendi nxit KLSH-në që:

- Të thellojë dhe përshpejtojë procedurat e auditimit mbi privatizimin e “Hotel Dajtit” nga Banka e Shqipërisë, për të rritur transparencën e këtij procesi dhe për të forcuar përgjegjshmërinë për zbatimin e ligjit;
- Të kryejë me përparësi auditimin e thelluar në drejtim të ndikimit në mjedis që kanë disa sektorë të veçantë, si koncesionet për ndërtimin e hidrocentraleve, dhënia e lejeve minerare etj;
- Të kryejë auditimin e procedurës së prokurimit për ndërtimin e rrugës Rrëshen-Kalimash-Kukës-Morinë;
- Të ndjekë me përparësi arkëtimin në buxhet të dëmit ekonomik të shkaktuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit apo edhe institucione të tjera, në të cilat KLSH ka zbuluar dëme të konsiderueshme.